



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Duke u bazuar në:**

1. Dispozitat e Nenit 14 paragrafi 2 dhe Nenit 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185.
2. Dispozitat e Nenit 6.3 të Rregullës për Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në sektorin e Energjisë.
3. Dispozitat e Nenit 6 të licencës për furnizim publik me ngrohje qendrore te NQ Termokos.
4. Kërkesën për miratimin draft dokumentit “Procedura për Shqyrtimin e Ankesave dhe Kërkesave të Konsumatorëve” të dorëzuar me datë 24.10.2013 nga ndërmarrja NQ “Termokos” SH.A., adresa: rruga “28 Nëntori”, pn-Dardani/Prishtinë, Republika e Kosovës.

**në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2014 nxori këtë:**

**VENDIM**

**I. APROVOHET “Procedura për Shqyrtimin e Ankesave dhe Kërkesave të Konsumatorëve” për NQ Termokos .**

**Arsyetim**

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 24.10.2013 ka pranuar kërkesën e të licencuarit-NQ Termokos SH.A. për miratim të draft dokumentit “Procedura e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve” .
  2. Pas shqyrtimit të draft-Procedurës të dorëzuar nga NQ Termokos dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** I licencuari obligohet që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë ta publikojë këtë Procedurë në faqen e tij elektronike zyrtare.
- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda (14) ditësh nga pranimi i Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Shtojcë:** "Procedura e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave të NQ Termokos".

**Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, Kryesues

---

Merita Kostari, Anëtare

---

Krenar Bujupi, Anëtar

